



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org.Jedinica Org Unit	02
Nr.Prot: Broj Prot: Prot.No:	05-10170
Nr.faqeje Br.stranica No.pagee	3-
Data: Datum: Date:	26/12/2024
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë/Ministry of Health/Ministarstvo Zdravstva

PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE/PSO

EMRI I PSO: SKRININGU I DËGJIMIT

PËRMBAJTJA: PËRSHKRIMI I PROCEDURAVE NË PROCESIN E
SKRININGUT TË DËGJIMIT PËR TË PORSALINDURIT

VERSIONI:[1.0]
DATA E APROVIMIT [24/12/2024]
AUTOR [GP/MSh/ShSKUK]
NR. I HAPAVE [IV]
NR. I NËNHAPAVE [12]

APROVUAR: Dr. Naim Bardiqi
Sekretar i Përgjithshëm, MSh



QËLLIMI	KJO PROCEDURË KA PËR QËLLIM TË PËRSHKRUAJ HAPAT E SKRININGUT TË DËGJIMIT PËR ÇDO TË PORSALINDUR, REFERIMIN E RASTEVE TË DYSHIMTA PËR EKZAMINIM TË MËTUTJESHËM SI DHE RAPORTIMI I REZULTATEVE TË FITUARA.
NDËRLIDHJA ME AKTET	<ul style="list-style-type: none"> • LIGJI NR 04/L125 PËR SHËNDETËSI • PROGRAMI PËR SKRININGUN NEONATAL - PLANI I VEPRIMIT 2023-2025 • STRATEGJIA PËR SHËNDETIN E NËNËS, FËMIJËS DHE SHËNDETIN RIPRODHUES - PV 2023-2025
LISTA E SHKURTESAVE	<p>KOGJ – KLINIKA GJINEKOLOGJIKE OBSTETRIKE</p> <p>SISH – SISTEMIT INFORMATIV SHËNDETËSOR</p> <p>ORL- OTORINOLARINGOLOGJI</p>

PROCEDURA

Nr.	HAPI	NËN-HAPAT
I	Ekzaminimi i të porsalindurit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Për ekzaminimin e dëgjimit të të porsalindurit përdoret pajisja për ekzaminim të dëgjimit /portabël; 2. Ekzaminimi kryhet më lehtë kur fëmija është në mes 12-18 orëve të para të jetës; 3. Ekzaminimi nuk bëhet deri në 4 orë pas lindjes për shkak të përmbajtjeve të mbetura në kanalën e veshit; 4. Çdo ekzaminim përbëhet nga jo më shumë se dy përpjekje në secilin vesh.
II	Rishqyrtimi dhe Testimi i Dëgjimit të Foshnjave pas Ekzaminimit Fillestar	<ol style="list-style-type: none"> 1. Nëse ekzaminimi fillestar dështon në njërin ose të dy veshët, duhet të rishqyrtohet të paktën një herë, por jo më shumë se dy herë para lirimimit nga materniteti/spitali/ KOGJ; 2. Ekzaminimi dhe ri-ekzaminimi duhet të kenë një interval prej rreth 4 orësh mes tyre. 3. Ekzaminimi i tepërt mund të rezultojë në rezultat dhe interpretim të pasaktë; 4. Foshnjat që nuk kalojnë ekzaminimin e parë duhet të bëjnë një testim të plotë të dëgjimit para moshës tre muajshe te specialisti i ORL-së.
III	Interpretimi dhe Njoftimi i Rezultateve të	<ol style="list-style-type: none"> 1. Rezultati i gjeneruar nga pajisja për ekzaminim të dëgjimit interpretohet nga profesionisti në maternitet/spital të përgjithshëm/KOGJ; 2. Rezultati evidentohet edhe në databazë për skringing neonatal të dëgjimit ; 3. Për rezultatin jonormal (të dyshimtë) të testit të dëgjimit njoftohet prindi nga profesionisti shëndetësor në Institucion dhe referohet te specialisti i ORL-së.
IV	Databaza/ raportimi	<ol style="list-style-type: none"> 1. Databaza e të gjitha rasteve të përfshira në skringing të dëgjimit përgatitet nga Departamenti i SISH-it dhe të siguron qasje në këtë databazë për të gjitha institucionet ku ndodhin lindjet.